

## **RREGULLAT E PROMOCIONIT "SAMSUNG GALAXY Z FOLD5 dhe Z FLIP5"**

Përpara se të blini një prej pajisjeve, ju lutemi njihuni me këto rregulla të para-shitjes (në vijim "**Rregullat**"):

### **1. Organizator i para-shitjes**

Samsung Electronics Austria GmbH, me zyrën e saj të regjistruar në Vjenë në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri dhe numrin e regjistrimit FN 217924b (në vijim "**Samsung**") organizon para-shitjen e pajisjeve Samsung Galaxy Z Fold5 dhe Z Flip5 .

### **2. Periudha e para-shitjes dhe pajisjet**

Subjekt i para-shitjes janë pajisjet Samsung Galaxy Z Fold5 12/512\* dhe Z Flip5 8/512\*\* (në vijim veçmas "**Pajisja**" dhe bashkërisht "**Pajisjet**"). Para-shitja është në dispozicion për blerësit e Pajisjeve në territorin e Republikës së Kosovës në periudhën nga 26.07.2023 deri më 10.8.2023 ose më herët nëse përfundon stoku (në tekstin vijim: "**Periudha e Para-shitjes**").

\* 12 GB RAM dhe 512 GB memorie

\*\* 8 GB RAM dhe 512 GB memorie

Modelet me memorie 1 TB nuk përfshihen në këtë Promocion.

### **3. Përfitimet**

Nëse plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara në këto Rregulla, blerësi i Pajisjes ka të drejtë të blejë një Pajisje me dy herë më shumë memorie për ruajtjen e të dhënave me çmimin e modelit bazë të Pajisjes si më poshtë:

- fitoni të drejtën për të blerë Samsung Galaxy Z Fold5 12/512 me çmimin e Samsung Galaxy Z Fold5 12/256 (modeli bazë), ose
- fitoni të drejtën të blini Samsung Galaxy Z Flip5 8/512 me çmimin e Samsung Galaxy Z Flip5 8/256 (modeli bazë).

### **4. Kushtet e blerjes për të realizuar të drejtën e përfitimeve nga pika 3 e Rregullave**

Blerja e Pajisjes mund të bëhet tek partnerët e shitjeve të Samsung të renditur në pikën 6 të këtyre Rregullave, në kushtet e mëposhtme kumulative:

- a. Që blerësi të blejë Pajisjen gjatë Periudhës së Para-shitjes;
- b. Blerësi të blejë Pajisjen në faqen e internetit ose në një dyqan me pakicë te një partner i autorizuar i shitjeve Samsung në territorin e Republikës së Kosovës; Lista e partnerëve të autorizuar përcaktohet në pikën 6 të këtyre rregullave;
- c. Blerësi të blejë Pajisjen si përdorues fundor; Përdoruesit fundorë janë personat fizikë dhe juridikë nga territori i Republikës së Kosovës të cilët e blejnë pajisjen për nevojat e tyre dhe jo për nevojat e rishitjes ose shpërndarjes së mëtejshme;

### **5. Marrja në dorëzim i Pajisjes**

Të gjithë blerësit që blejnë një Pajisje gjatë Periudhës së Para-shitjes do të mund ta marrin atë nga një partner i shitjeve të Samsung, duke filluar nga 11.08.2023.

Shitja e rregullt e Pajisjes fillon më 11.08.2023.

## **6. Partnerët e autorizuar të shitjeve të Samsung**

Shitja paraprake e pajisjeve Samsung mund të bëhet vetëm tek partnerët e mëposhtëm të autorizuar të shitjeve të Samsung:

Neptun Kosova SH.P.K

WishByTech SH.P.K

Aztech SH. P.K.

Gjirafa SH. P.K.

EGS SH. P.K.

Te tjerë

## **7. Të dhënat personale të blerësit**

Për qëllimin e zbatimit të këtij Promocioni, Samsung nuk mbledh ose përpunon të dhënat personale të blerësit.

## **8. E drejta për të ndryshuar Rregullat**

Samsung rezervon të drejtën të bëjë ndryshime në këto Rregulla për arsye të justifikuara, me detyrimin për t'i publikuar ato pa vonesë.

Këto rregulla janë publikuar më 26.07.2023 në faqen <https://www.samsung.com/al/offer/preorder-galaxy-z-fold5-z-flip5-xk/>, datë nga e cila hyjnë në fuqi.